

## **NIKOLETA PIRANJANI**



Audituese e Lartë, Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit në KLSH.

Lindur në 1960. Diplomuar në Ekonomi për Industrinë(1984). Ka 31 vite pune. 16 vitet e fundit të punës në KLSH. Audituese e Lartë që nga muaji qershor 2012. Fusha e ekspertizës: Auditimi i Buxhetit të Shtetit dhe Borxhit Publik

## **STANDARDI DHE CILËSIA E AUDITIMEVE<sup>1</sup>**

*nga Nikoleta Piranjan*

Për vitin 2012 dhe në vazhdim auditimet e kryera në institucionet publike si dhe pasqyrimi i dokumentimit të këtyre auditimeve, kanë pësuar ndryshime esenciale strukturore dhe në përmbajtje. Këto ndryshime kanë ardhur si rezultat i ndryshimeve të rregullores së miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH Nr.53 Dt. 16.04.2012 , rregullore ku në të cilën janë përfshirë në mënyrë të hollësishme standardet ndërkombëtare të auditimit ( të rregullshmërisë përputhshmërisë, ligjshmërisë; të performancës; të auditimit financiar dhe të auditimit të pasqyrave financiare ). Në këtë rregullore gjithashtu në mënyrë të konkretizuar janë përfshirë zbatimi i standardit për kontrollin e cilësisë, kodit të etikës dhe konfliktit të interesave, si dhe shumë përmirësime në procedurat, që domosdoshmërisht duhet të ndiqen në procesin e kryerjes së të gjithë fazave të një auditimi.

Referuar eksperiencës disa vjeçare në KLSH, eksperiencë e konkretizuar në materialet përkatëse të auditimit, referuar zbatimit të rregullave të vendosura në Rregulloret e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në gjithë këto vite, konkludojmë se raportimi i auditimeve të

kryera si dhe vetë procesi i auditimit ka kaluar në një shkallë më të lartë të zhvillimit të tyre.

Përmirësime të dukshme ka pasur në performancën e raportimit, si të projektraporteve ashtu dhe të raporteve përfundimtare, pasi këto dokumente janë hartuar referuar një standardi të mirë përcaktuar, pra janë unifikuar për mënyrën e pasqyrit të tyre. Kjo ka çuar në rritjen e cilësisë së raportimit, në rritjen e transparencës së Raportimit dhe për rrjedhojë në rritjen e përshtatshmërisë së përdorimit të raporteve të auditimit nga një publik më i gjerë.

Në lidhje me transparencën e auditimit gjatë kësaj periudhe hop cilësor ka pasur dhe në publikimin e këtyre raporteve në faqen web të klsh, ku në mënyrë periodike dhe hap pas hapi paraqiten këto raporte me transparencë të plotë, ku një publik i gjerë dhe me interes, në mënyrë të drejtpërdrejt mund të identifikojë subjektet e audituara, konkluzionet e auditimit si dhe grupin auditues. Ky informacion jepet publik nëpërmjet kësaj faqeje, pavarësisht informacionit të përmbledhur të paraqitur në buletinet 4 mujore të këtij institucioni.

Nga institucioni i KLSH në drejtim të nxitjes për një rritje të integritetit dhe përgjegjshmërisë në punë të menaxherëve të institucioneve publike të audituara dhe për raste flagrante të shkeljeve të legjislacionit në fuqi njoftohet, Këshilli i Ministrave menjëherë mbas përfundimit të auditimit, për rezultatet e këtij auditimi. Ky proces do të ndihmojë në vijimësi ndërgjegjësimin e qeverisjes në drejtim të menaxhimit të fondeve buxhetore me efektivitet të plotë si dhe identifikon luftën në vazhdimësi të KLSH – së kundër korrupsionit dhe moszbatimit të ligjit.

Gjithashtu dua të theksoj se vetë procedurat e vendosura për çdo fazë të auditimit në subjekt, si dhe dokumentacioni i domosdoshëm i mbajtur, për të

identifikuar procedurën përkatëse, imponojnë dhe për rrjedhojë përkthehen në rritje të cilësisë së auditimit. Këtu dua të theksoj domosdoshmërinë e kryerjes dhe dokumentimit të takimeve ballafaqese me subjektin dhe personat përgjegjës, ku këto të fundit në çdo fazë të auditimit janë në korrent të opinioneve të audituesve për shkeljet përkatëse. Kjo në auditimet tona ka rezultuar procedurë efektive , pasi tani më, janë eliminuar në shumicën e rasteve, pretendimet e subjekteve që nuk kanë pasur njohuri për konstatimet nga auditimi.

Dhënia e detyruar e informacionit për ecurinë e punës, strukturave menaxhuese të auditimit, ka rritur nivelin e programimit të punës audituese për çdo auditues, pasi referuar këtyre informacioneve, secili pasqyron në mënyrë periodike punën audituese të kryer. Gjithashtu në këtë mënyrë drejtuesi direkt i grupit të auditimit, monitoron punën në terren.

Hap cilësor mendoj se ka qenë dhe vendosja e rekomandimeve për subjektin auditues, që në projekt raportin e auditimit dhe marrja paraprakisht e mndimit të subjektit për rekomandimet e lëna. Kjo ka çuar në faktin se nga ana e audituesve dhe për rrjedhojë dhe e institucionit të KLSH, lihen rekomandime më të qenësishme, reale dhe jo formale dhe plotësisht të realizueshme.

Kjo me siguri do të përkthehet hap pas hapi me rritje të % të realizimit të rekomandimeve të lëna dhe me rritje të përgjegjshmërisë së realizimit të këtyre rekomandimeve nga subjektet përkatëse .

Mendoj se ka shumë për të bërë nga audituesit për të ardhmen në disa drejtime, duke qenë se vetë profesioni i audituesit kërkon njohuri të vazhdueshme në drejtim të legjislacionit dhe standardeve :

Së pari mendoj se duhet shumë punë në drejtim të përvetësimit maksimal të standardeve aktuale dhe njohjen e vazhdueshme me standardet e reja. Këtë fakt e ndihmon shumë organizimi i trajnimeve të brendshme e të jashtme të realizuara nga institucioni si dhe testimi i dijeve të mara.

Në drejtim të përmirësimit të komunikimit dhe informimit brenda grupit referuar arritjes së objektivave të auditimit, duke e përkthyer këtë si bashkëpunim për çështje të përbashkëta të auditimit krahas përgjegjësiive personale të auditimit, referuar fushave ku ne auditojmë.

Përmirësime duhet të ketë dhe në programimet e auditimeve si në drejtim të përcaktimit të grupeve të auditimit, ashtu dhe afatit optimal të kryerjes së gjitha fazave të tij. Përcaktimi me objektivitet i këtyre afateve sigurisht shoqërohet me punë audituese korrekte dhe me cilësi auditimi.

Megjithatë pavarësisht arritjeve në auditim, procesi i integritetit dhe rritjes së vazhdueshme profesionale është një proces që duhet të jetë i vazhdueshëm më shumë se kudo tjetër, në institucionet audituese. Prandaj audituesit, pavarësisht përvojës shumë vjeçare të tyre, janë njëkohësisht profesionist dhe nxënës të përjetshëm.

---

<sup>i</sup> Botuar në Gazetën "Telegraf" dt. 27 Qershor 2013